

STRUKTURA E SHKOLLIMIT TË DETYRUESHËM

Shkollimi i detyrueshëm përfshin tri cikle:

- **Cikli 1** : nga viti i 1-rë tek i 4-ti (nxënës 4 - 8 vjeç)
- **Cikli 2** : nga viti i 5-të tek i 8-ti (nxënës 8 - 12 vjeç)
- **Cikli 3** : nga viti i 9-të tek i 11-ti (nxënës 12 - 15 vjeç).



KONTEKSTI ROMAND

Në Zvicrën romande, të gjitha Parlamentet kantonale e kanë ratifikuar **Konventën shkollore romande**. Ajo përcakton bashkëpunimin në fushën e planeve të studimeve, të mjeteve arsimore, të strukturës shkollore, të formimit të arsimtarëve dhe arsimtareve, në përputhje me marrëveshjen ndërkantonale.

>>> vijimi në : www.ciip.ch

KONTEKSTI KOMBËTAR DHE NDËRKANTONAL

Kantonet zvicerane në shumicën e tyre e kanë miratuar **Marrëveshjen ndërkantonale mbi harmonizimin e shkollimit të detyrueshëm** (marrëveshjen HarmoS). Ky dokument saktëson se planet e studimeve duhet të jenë të bashkërenduara sipas rajoneve gjuhësore. Ai përcakton gjithashtu strukturën shkollore për njëmbëdhjetë vjetët e shkollimit të detyrueshëm dhe cakton moshën e fillimit të shkollimit.

>>> vijimi në : www.cdip.ch

PERSPEKTIVAT

Vënia në veprim i PRS –së shoqërohet me mjete mësimore romande shumë prej të cilave janë duke u krijuar. Paleta e këtyre mjeteve për lëndët e ndryshme pasurohet në mënyrë progresive sipas kalendarit të hartuar prej KNAP-së.

>>> Planifikimi i mjeteve mësimore romande gjendet në www.ciip.ch

PLATFORMA E PLANIT ROMAND TË STUDIMEVE

PRS-ja gjendet në linjë. Atje, ju mund ta zbuloni në tërësinë e tij. Por, së pari ai është një vegël pune për arsimtarët dhe arsimtarët; kjo shpjegon faktin që në të përdoren terma specifike të arsimit dhe të lëndëve shkollore. Një fjalorth saktëson disa terma.

Platforma lejon gjithashtu qasjen në dokumentet plotësuese kantonale.



Për të mësuar më tepër >>> www.plandetudes.ch



www.erz.be.ch



www.fr.ch/senof



www.ge.ch/primaire
www.ge.ch/co



www.jura.ch/sen



www.ne.ch/se0



www.vs.ch



www.vd.ch/dgeo

Faubourg de l'Hôpital 68
Case postale 556
CH-2002 Neuchâtel

T +41 32 889 69 72
F +41 32 889 69 73
ciip@ne.ch
www.ciip.ch



CONFÉRENCE INTERCANTONALE
DE L'INSTRUCTION PUBLIQUE DE
LA SUISSE ROMANDE ET DU TESSIN

PER

Plani romand i studimeve (Plan d'études romand, PER)

Dokument informimi për prindërit

Në fillim të vitit shkollor 2013-2014, të gjithë nxënësit e shkollimit të detyrueshëm në Zvicrën romande do të studojnë duke ndjekur objektivat e përcaktuara në PRS. Ky harmonizim u përgjigjet neneve kushtetuese mbi edukimin të miratuara prej popullit dhe kantoneve zvicerane me një shumicë shumë të gjerë më 21 maj 2006.

Të dashur prindër,

Plani romand i studimeve është në qendër të procesit të harmonizimit të shkollimit të detyrueshëm. Ai u miratua më 27 maj 2010 prej Drejtorëve kantonalë të arsimit publik, në përfundim të një procesi të gjatë përpilimi e konsultimi. Pra, ai mbështetet në një konsensus të gjerë. Ai nuk ka asgjë revolucionare as thellësisht inovatore, veç faktit se, nën kujdesin e Konventës shkollore romande, do të bëhet referenca qendrore dhe e përbashkët e objektivave të arsimit për të shtatë kantonet frëgjishtfolëse ose dygjuhëshe të Zvicrës perëndimore. Ai do të futet në mënyrë progresive në të gjitha ciklet e arsimit të të gjitha kantoneve romande (nga tani deri të fillim të vitit shkollor 2014), duke përcaktuar pjesën më të madhe të përmbajtjeve mësimore të njëmbëdhjetë viteve të shkollimit të detyrueshëm. Zgjedhja e mjeteve mësimore dhe përgjegjësia pedagogjike e arsimtarëve në klasën e tyre lënë sidoqoftë një hapësirë manovrimi që është në përputhje me harmonizimin e dëshiruar prej popullit dhe kantoneve zvicerane.

Kjo fletë vë në dispozicionin tuaj informacione bazë që mundësojnë kuptuarjen në mënyrë globale të organizimit të PRE-së, ndërsa për informacione të mëtejshme, ekziston edhe një broshurë më e plotë për çdo cikël (www.plandetudes.ch). Për marrjen e këtyre dokumenteve të ndryshme apo të një versioni të kësaj flete në një gjuhë tjetër, lutemi t'i drejtoheni shërbimit të arsimit të administratës kantonale. Shpresojmë se leximi i kësaj flete do të kënaqë kureshtinë tuaj të ligjshme.



Konferenca latine e arsimit të detyrueshëm, Maj 2013

VULLNETI POLITIK

Konferenca ndërkantonale e arsimit publik (KNAP) miratoi më 2013 një Deklaratë mbi qëllimet dhe objektivat e Shkollës publike që përbën bazën e projektit global të formimit të nxënësit.

« Shkolla publike ka misionin arsimor dhe transmetim kulturor tek të gjithë nxënësit. Ajo siguron marrjen e njohurive dhe përfundimin e kompetencave që i lejojnë secilit e secilës zhvillimin e potencialeve të veta në mënyrë optimale. »

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

- > Misionet e arsimit dhe transmetimit kulturor (marrja e njohurive dhe përfundimi i kompetencave) >>>
- > Misionet e edukimit dhe transmetimit të vlerave shoqërore >>>
- > Përfundimi dhe zhvillimi i kompetencave dhe aftësive të përgjithëshme >>>

Për të mësuar më tepër >>> www.plandetudes.ch

*KNAP-ja mbledh shfaqjet e departamenteve të ngarkuar me edukimin të të gjitha kantoneve romande, si dhe të Ticinos. Ajo përgjigjet për harmonizimin e programeve dhe zgjedhjen e teksteve shkollore.

Një projekt global formimi

Veprimtaritë e kryera prej shkollës hyjnë në një projekt global formimi të kokretizuar prej Planit romand të studimeve (PRS). Ai përshkruan mësimet që çdo nxënës do të marrë gjatë tërë shkollimit të detyrueshëm.

Fushat e lëndëve

mbulojnë tërësinë e lëndëve shkollore të përbashkëta për të gjitha kantonet romande. Secila përbëhet nga shumë lëndë që kanë lidhje midis tyre.

GJUHËT

Të dish të komunikosh në gjuhën tënde dhe në gjuhë të tjera është bërë e domosdoshme në botën e sotme. Gjatë tërë shkollimit, nxënësit do t'i kërkohej të zhvillojnë në mënyrë progresive kompetencat e veta në gjuhën e arsimimit, frëngjishten, dhe aftësinë për të komunikuar në dy gjuhë të tjera, gjermanisht dhe anglisht.

MATEMATIKA DHE SHKENCAT E NATYRËS

Përfitimi i njohurive dhe zëllimi i frymës shkencore janë thelbësore për kuptimin e botës së sotme. Për këtë qëllim, nxënësi do të punojë nocione në matematikë dhe shkencë, si dhe rrugë për zgjidhjen e problemeve dhe kuptimin e disa situatave reale.

SHKENCAT NJERËZORE DHE SHOQËRORE

Kuptimi i përfitimeve të shoqërisë në përmasat e tyre shoqërore, kulturore, ekonomike, politike dhe mjedisore bën pjesë në kompetencat e pritura nga çdo individ. Nxënësi dhe nxënësja, qytetar i ardhshëm dhe qytetare e ardhshme, do të kenë qasje në njohuri gjeografike, historike dhe qytetare që do t'i mundësojnë që të kuptojë shoqërinë dhe të marrë pjesë në ecurinë e saj.

ARTET

Eksplorimi i shprehjeve të ndryshme (vizuale, zanore, ...) dhe praktikimi i veprimtarive artistike stimulojnë krijimtarinë. Nga ana tjetër, nxënësi do të ndërtojë referenca kulturore dhe do të zhvillojë mënyra dhe teknika të shprehjeve artistike që do t'i lejojnë të zgjerojë dhe zhvillojë perceptimin e botës që e rrethon.

TRUPI DHE LËVIZJA

Zhvillimi i aftësi të veta fizike dhe psikike me anën e lëvizjes, ashtu si edhe njohuria ushqyese, duhet të lejojë njohjen e trupit të vet dhe përkujdesjen për të. Nxënësi do të ushtrojë praktika sportive dhe do të zhvillojë njohuri të lidhura me një ushqyerje të shëndetshme dhe të barazpeshuar.

PLANI ROMAND I STUDIMEVE ËSHTË ORGANIZUAR NË TRI ZËRA :

FUSHAT E
LËNDËVE

AFTËSITË
TRANSVERSALE


FORMIMI I
PËRGJITHSHËM

Projekti i formimit i mban parasysh të tre zërat gjatë tërë shkollimit.

Formimi i përgjithshëm

përmbledh tematika të natyrave të ndryshme që shkolla duhet t'i marrë parasysh për çdo nxënës.

Formimi i përgjithshëm qartëson raportet që nuk kanë të bëjnë vetëm me lëndët shkollore. Ai i bën të dukshme pikërisht prurjet edukative dhe vë në dukje, për shembull, rëndësinë për ta njohur nxënësin, qytetarin e ardhshëm dhe qytetaren e ardhshme, me kompleksitetin e botës, me kërkimin dhe trajtimin e informacioneve të larmishme, me ndërtimin e argumentimeve apo edhe me fushën e parandalimit dhe atë të shëndetit.



Kapacitetet transversale

janë aftësi të domosdoshme për suksesin e nxënësive. Ato zhvillohen përmes punës disiplinore dhe në mënyrë progresive bëhen, për nxënësin, vegla në shërbim të nxënësive të tij.

Gjatë tërë shkollimit të tij, nxënësi në nxënësitë e tij do të mbështetet në aftësitë transversale që janë të përbashkëta për të gjitha lëndët dhe për veprimtari të shumta që zhvillohen në klasë. Këto aftësi nuk jepen në mësim si të tilla, por nxënësi i përfiton duke zgjidhur probleme, duke komunikuar në gjuhën amtare apo në një gjuhë të huaj, duke realizuar projekte artistike. Ato përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të bagazhit që çdo nxënës do të duhej të zhillonte për integrimin e tij shoqëror e profesional.